

VENDIM
Nr. 65, datë 14.2.2024

PËR ORGANIZIMIN E ZYRAVE VENDORE TË AVOKATURËS SË SHTETIT

(Ndryshuar me VKM nr. 54, datë 29.1.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1.5, të nenit 11, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Avokatura e Shtetit në nivel vendor organizohet në 6 (gjashtë) zyra me kompetencat tokësore, si më poshtë vijon:

- a) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në:
 - i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
 - ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
 - b) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë, me kompetencë tokësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 - c) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Lushnjë, me kompetencë tokësore në:
 - i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 - ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 - iii. Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
 - ç) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Lezhë, me kompetencë tokësore në:
 - i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 - ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 - iii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
 - d) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Tiranë, me kompetencë tokësore, në:
 - i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
 - ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 - iii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - iv. Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
 - v. Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
 - vi. Gjykatën Administrative të Apelit.
 - dh) Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë, me kompetencë tokësore në:
 - i. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 - ii. Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku